

KULTURA 2023



Nr.17

BULETINI MUJOR / MAJ

kultura.gov.al



SHQIPËRIA, EPIQENDRA E SALLONIT NDËRKOMBËTAR TË LIBRIT NË TORINO

Nga data 18-22 maj u zhvillua edicioni i 35-të i Sallonit Ndërkombëtar të Librit në Torino. Në ceremoninë e hapjes së Sallonit përshëndeti ministrja e Kulturës Elva Margariti: "Ka qenë një pritje e gjatë, një "bregë e bukur" siç thotë shkrimtari ynë i madh Kadare dhe nuk mund të mos e pranoni ftesën për të qenë jo thjesht pjesëmarrës, por miq. Ishte një periudhë shumë e shkurtër për t'u përgatitur, por në të njëjtën kohë një mundësi shumë e madhe për ne, për të treguar Shqipërinë letrare. Kam jetuar 16 vjet në Itali dhe e di fare mirë se është dashur shumë punë për të ndryshuar imazhin tonë, dhe këtë ftesë e shoh si një stacion të rëndësishëm në rrugëtimin tonë, që finalen e ka me anëtarësimin në familjen e madhe europiane, ku gjeografikisht dhe shpirtërisht gjithnjë kemi qenë pjesë". I frymëzuar nga një prej veprave të shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare, "Kronikë në gur", salloni shqiptar, projektuar nga ark. Matilda Pando dhe artisti Ergys Krisiko tërhoqi vëmendjen e mijëra vizitorëve, që ndaleshin për

PËRGJATË 5 DITËVE TË SALLONIT TË TORINOS U ZHVILLUAN RRETH 40 AKTIVITETE, PROMOVIME LIBRASH TË PËRKTHYER NË GJUHËN ITALIANE

ta vizituar dhe bërë fotografi në të. Përgjatë 5 ditëve të Sallonit të Torinos u zhvilluan rreth 40 aktivitete, promovime librash të përkthyer në gjuhën italiane, panele diskutimesh mbi letërsinë bashkëkohore me një prani të pasur autorësh e studiuesish shqiptarë e italianë. Morën pjesë: Lea Ypi, Ornella Vorpsi, Bashkim Shehu, Ermal Meta, Lucia Nadin, Virgjin Muçi, Tom Kuka, Ardian Ndreca, Ardian Kuçuku, Darien Levani, Rita Petro, Fatos Kongoli, Ylljet Aliçka, Durim Taçi, Anilda Ibrahim, Artur Spanjoli, Stefan Çapaliku, Mimoza Hysa, Diana Kastrati, Liridon Mulaj, Andreas Dushi, Tobias Xhaxhiu, Denada Ndreca, Christian Elia, Nicola Petrazzi, Fabio Rocchi, Sonila Strakosha etj. Realizimi i këtij salloni u bë i mundur falë bashkëpunimit të Ministrisë së Kulturës me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, Shoqatën e Botuesve Shqiptarë, Regione Puglia, Qendrën Shqiptare në Torino, Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universitetin e Tiranës, Ambasadën Shqiptare në Romë.



SHQIPËRIA NË "LABORATORIN E SË ARDHMES" NË BIENALEN E ARKITEKTURËS NË VENECIA

Shqipëria merr pjesë në edicionin XVIII të Bienales Ndërkombëtare të Arkitekturës në Venecia. I hapur në datën 19 maj, pavijoni shqiptar do të qëndrojë i hapur deri në muajin nëntor të këtij viti. Kuruar nga Era Mercuri dhe Martin Gjoleka, kjo ekspozitë në bashkëpunim me Ani Markun dhe Gerardo Prendushin, synon të prezantojë tipologji të reja të hapësirave qytetëse. Me temën "Përsiatje të pakohë: ose si mësojmë të jetojmë në realitete të sintetizuara", ekipi shqiptar i bashkohet "Labororit të së ardhmes" të këtij edicioni, kuruar nga Lesley Locco.



"NOTRE DAME DE PARIS", MUZIKALI I REKORDEVE BOTËRORE, SUKSES NË TIRANË

Muzikali i rekordeve botërore, "Notre Dame de Paris" ngriti peshë Tiranën. Një spektakël i jashtëzakonshëm, që mban firmën e kantautorit Riccardo Cocchiante mbushi stadiumin "Air Albania". Nën interpretimin e këngëtarëve Elhaida Dani, Angelo Del Vecchio, Gian Marco Schiaret-ti, Eric Jetner, Emma Lépine Perso, Robert Marien etj., në shoqërinë e një grupi të jashtëzakonshëm balerinësh e akrobatësh, skenografisë dhe kostumografisë, kjo vepër ishte shembulli i magjisë që dhuron një vepër e përjetshme si ajo e mbështetur në romanin e Victor Hugo.

PAS 8 VITEVE MUNGËSE RIKTHEHET FESTIVALI FOLKLORIK KOMBËTAR NË GJIROKASTËR

Festivali do të zhvillohet nga data 24 qershor deri më 1 korrik 2023 dhe do të presë artistë dhe grupe artistike nga 12 qarqet e vendit, si dhe nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi etj. Në skenën tradicionale të Kalasë do të ngjiten edhe grupe muzikore folklorike nga arbëreshët e Italisë, të shqiptarëve nga Greqia, Italia, Mbretëria e Bashkuar, Zvicra dhe ShBA-ja. Të gjitha minoritetet dhe dëshmitë e tyre muzikore dhe koreografike janë të përfaqësuara në festival brenda grupeve të qarqeve përkatëse. Festivali mbështetet nga buxheti i shtetit me një fond prej 135 milionë lekësh, përveç kontributit të çdo qarq. Drejtor Artistik i festivalit është prof.Thoma Gaqi dhe regjisor është Bledi Laço. Pjesë e grupit organizativ janë: Eri Kuke, Edit Pula, Dorian Çene etj. Të ftuar gjatë netëve të këtij Festivali do të jenë grupe të mirënjohura si Elif Sanchez nga Spanja, një nga këngëtarët më të njohur të Republikës së Maqedonisë së Veriut Vladko Stefanovski, Les Swing Cabaret Musical nga Franca, për të kulmuar me natën finale me pjesëmarrjen e Orchestra Italiana e Renzo Arbore-s.



NISIN JAVËT KULTURORE NDËRKOMBËTARE, 20 SHTETE NË EDICIONIN E DYTË

Bashkimi Europian e më pas Greqia startuan Javët Kulturore Ndërkombëtare. Një vit më parë Javët Kulturore Ndërkombëtare nisën si një ftesë për ta sjellë botën te ne, me moton "Shqipëria mikpret botën!" Më shumë se 700 artistë pjesëmarrës nga 19 vende të botës, u ngjiten në skenë dhe performuan me artistët tanë duke përcjellë traditën, tingujt, imazhet, aromat dhe shijet nga të gjitha këndet e botës. Edicioni i këtij viti sjell 20 shtete dhe organizma ndërkombëtarë. Këtë vit vijonë për herë të parë Holanda, Mali i Zi dhe Azerbajxhani. Maratona kulturore nisi në datën 16 maj me Bashkimin Europian, për të vijuar me Greqinë, Italinë e me radhë, Francën, Spanjën, Egjiptin, Kinën, Japoninë, Gjermaninë, Austrinë, Hungarinë dhe përmbillet në muajin nëntor me Javën Kombëtare të të gjithë shqiptarisë.

20 SHTETE
DO TË MARRIN PJESË NË EDICIONIN E DYTË TË JKN.
MARATONA KULTURORE NISI NË DATËN 16 MAJ ME BASHKIMIN EUROPIAN

PËRFUNDON RESTAURIMI I MOZAIKUT TË MUZEUT HISTORIK KOMBËTAR

Në datën 16 maj u zhvillua ceremonia e rizbulimit të mozaikut të restauruar, "Shqipëria". Pas një pune të gjatë e të kujdeshme, nën drejtimin e mjeshtër Agron Islami, zëvendësimit pjesëz pas pjesëze me të njëjtat materiale të prodhuara 40 vite më parë në Itali, u përfundua mozaiku-simbol i Muzeut Historik Kombëtar. Së bashku me ambasadorën e Bashkimit



Europian Christiane Hohmann, përfaqësues të trupave diplomatike në Tiranë, UNOPS u rizbulua vepra e artistëve Vilson Kilica, Anastas Kostandini, Aleksandër Filipi dhe Josif Droboniku. Ky mozaik paraqiste problematika të shumta për shkak të dëmtimeve nga agjentët atmosferikë dhe

nga tërmeti i vitit 2019. Restaurimi i këtij mozaiku u përfshi në programin EU4CULTURE, i cili mbështetet nga Bashkimi Europian me një fond prej 40 milionë eurosh dhe zbatohet nga UNOPS.